

REPUBLIKA E SHQERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1334 Rep.
Nr. 123 Kol.



KONTRATE SHITJE

(transferim i pjeseve te kapitalit te shoqerise tek te tretet)


Sot, me date 29. 6. 2000 (dymije), ditën e *Shtunel*, para meje noteres
Mimote Shaha, Notere ne Tirane, me Seli ne Rr. *Durrës Sh. Nr. 5*
u paraqiten personalisht:

SHITESI: NERITAN DOJAKA, I biri I Abazit, I datelindjes 1967, banues ne Tirane
Rr. Bajram Curri, Pall. 67/1 Ap. 8, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, I
pajisur me pashaporten me nr. QH 362149.

BLERESIT: 1. BLENDAR ÇERIBASHI, i biri i Kasemit, I datelindjes 1956, banues ne
Tirane, Rr. Mihal Grameno, Pall. 7/1 Ap. 5, madhor e me zotesi te plote juridike per te
vepruar, I pajisur me pasaporte me nr. AZ 053079.

2. CARLI GIUSEPPE, I biri I Angelos, lindur ne Trani, me 1961, banues ne
Barletta, Itali, shtetas italian, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, I pajisur
me pasaporten nr. 7930001.

1. SHITESI NERITAN DOJAKA, eshte ortak I vetem I Shoqerise "Alba-Elettrica 2"
sh.p.k. me kapital themeltar 100.000 (njeqindmije) leke, rregjistruar si person juridik
me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 9470, dt. 06.03.1995, me ndryshimet e
bera me Vendimin e po asaj Gjykate te dates 12.07.1996, me seli ne Rr. Bajram Curri,
Pall. 67/1/8. Me vendimin nr. 2 date 03.01.2000 te Asamblese se Ortakut te Vetem
eshte vendosur qe t'i shese ne formen e transferimit, nga 33,3 % (tridhjetete pike tre
perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise "Alba-Elettrica 2" perkatesisht blesesve
BLENDAR ÇERIBASHI dhe CARLI GIUSEPPE, kurse pjesa e mbetur e kapitalit
themeltar prej 33,4% (tridhjetete pike kater perqind) do te vazhdoje te mbahet ne
pronesi nga shitesi.
2. Çmimi I shitjes eshte ne vleren prej 66.600 lekesh duke u ndare nga 33.300 leke per
secilin prej blesesve dhe do te paguhet ne momentin e nenshkrimt te aktit te shitjes.
3. Me nenshkrimin e kesaj kontrate-shitjeje dhe realizimin e shenimeve perkatese ne
rregjistrin themeltar, BLERESIT behen pronare te pjeseve perkatese te kapitalit dhe
ortake te shoqerise "Alba-Elettrica 2" sh.p.k., kurse Shitesi e humb te drejten e
pronesise per pjeset e shitura te kapitalit.
4. BLERESIT kane te drejten e marrjes se teresise se dividendeve te vena ne shperndarje
pas shitjes edhe sikur ato t'i perkasin nje ushtrimi te mbyllur perpara kesaj date.
5. BLERESIT nuk mund t'i kerkojne shitesit qe ai te kontribuojte ne pastrimin e atyre
humbjeve qe kane qene perpara shitjes.

- 
6. SHITESI ju garanton BLERESVE : - gezimin e qete te pjeseve te shitura dhe heq dore nga çdo akt qe mund t'i zhveshe keto pjese nga substanca e tyre; - saktesine e informatave te dhena per pasurine e shoqerise dhe angazhimet kryesore ndaj te treteve te kontraktuara nga shoqeria; - saktesine e bilancit qe ka sherbyer si baze per percaktimin e çmimit te shitjes si dhe angazhimin se do te marre ne ngarkim te gjitha detyrimet qe nuk figurojne ne kete bilanc dhe qe do te zbulohen pas dates se shitjes.
 7. Gjithçka tjeter e papercaktuar ne kete kontrate do te zgjidhet sipas dispozitave te Ligjit "Per shoqerite tregtare" dhe Kodit Civil.
 8. Per te vertetuar sa me siper u hartua kjo kontrate shitjeje e cila u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te paleve, u nenshkrua sipas ligjit ne pranine time dhe une Noterja e vertetoj ate rregullisht.

Tirane, me 29 . 4 . 2000

SHITESI
NERITAN DOJAKA



BLERESIT
BLEDAR CERIBASHI



CARLI GIUSEPPE

